



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Datë: 15/09/23 Ref.: 1212/23

Në mbështetje të nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ, Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-031 (GZ, Nr.20/12 Qershor 2016), Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (tutje KShC), në mbledhjen e 115-të, të mbajtur me datë 25.08.2023, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e ish-Kolegjit Dukagjini për korrigjim të vendimit të KShC-së me Ref.Nr.505/13, datë 08.07.2013.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Ish-Kolegji Dukagjini bazuar në kërkesat e studentëve të cilët nuk mund të nostrifikojnë diplomat jashtë vendit, ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim përkatësisht në Këshillin Shtetëror të Cilësisë (në mënyrë elektronike përmes emailit zyrtar) me të cilën ka kërkuar që të korrigjohet vendimi i KShC-së me Ref.Nr.505/13, datë 08.07.2013.


Të dhënat, sipas kërkesës së ish-Kolegjit Dukagjini, janë prezantuar në mbledhjen e KShC-së të mbajtur me 25.08.2023 dhe pas shqyrtimit të detajuar të kërkesës, verifikimit të dokumentacionit relevant, KShC mori vendim që të refuzojë kërkesën për faktin se nuk ka arritur të siguroj dëshmi që Kolegji Dukagjini në periudhën kontestuese i është nënshtruar akreditimit institucional ashtu siç kërkohet me legjislacionin në fuqi për fushën përkatëse, përkatësisht me nenin 8 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës.

Andaj KShC në përputhje me legjislacionin në fuqi, faktet e prezantuara dhe kompetencat ligjore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në organin kompetent në afatin prej 30 ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ.

Vendimi iu dërgohet:

- Ish-Kolegjit Dukagjini;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Hasim Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

